

BULETIN

No3

UJI I KOSOVËS

#ujëpërkosovën

Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore (ARPL) ka një rol qendror në menaxhimin e resurseve ujore në të gjithë vendin. Kapacitetet e përmirësuara të ARPL-së bëhen mjete më efektive në prezantimin e menaxhimit të resurseve ujore që do të funksionojnë për mjedisin, ekonominë dhe popullin e Kosovës.



Integrated Water Resources
Management in Kosovo

EDITORIAL



FRANK WIEDERKEHR
ZËVENDËS CEO I SKAT & DREJTOR I PROGRAMIT
IWRM-K

PROGRAMI IWRM-K MUND TË BËHET MODEL PËR VENDET E TJERA

“Menaxhimi i Integruar i Resurseve Ujore në Kosovë” është një nga programet kryesore të Skat Consulting. Është fryt i partneritetit të gjatë, me dekada, ndërmjet Kosovës dhe Zvicrës në menaxhimin e resurseve ujore. Ne, në Skat Consulting, ndjehemi të nderuar që Qeveria Zvicerane dhe Agjencia e saj për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) na kanë besuar mjetet financiare dhe përgjegjësinë për të katalizuar përmirësimet sistematike të sektorit të ujit në Kosovë.

Në këtë rrugëtim për të ndihmuar Republikën e Kosovës në krijimin e një sistemi të shëndoshë dhe të qëndrueshëm të menaxhimit të ujit, ne jemi partnerë me disa organizata nga Austria dhe Zvicra, të cilat Programit i sjellin përvoja dhe ekspertizë shumë të vlefshme, ku institucionet e Kosovës dhe palët e tjera vendore të interesit mund t'i qasen lehtësisht. Për të lehtësuar ndryshimin e dëshiruar, ne vendosëm Njësinë e Lehtësimit të Programit me profesionistë kompetentë me përvojë dhe atyre të rinj, shumë të motivuar për të mbështetur përparimin dhe të ardhmen e qëndrueshme të vendit.

Dizajni inovativ i Programit dhe puna e palodhur e të gjithë aktorëve të përfshirë gjatë 20 muajve të fundit kanë dhënë tashmë rezultate që rrisin perspektivat për një sukses më të madh. Kombinimi i hulumtimit, grumbullimit të të dhënave dhe dokumentacionit të planifikimit, i përkrahur nga mbështetja për zhvillimin e kapaciteteve dhe nga investimet e synuara, mobilizon palët e interesit në një proces që do të sigurojë një të ardhme të qëndrueshme (ujore) për Kosovën.

Nëse zbatohet siç parashikohet, Programi mund të shndërrohet gjithashtu në një model rajonal dhe ndërkombëtar nga i cili mund të përfitojnë vendet dhe projektet e tjera.

E fundit, por jo më pak e rëndësishme, është arritja e pjesëmarrjes më të gjerë e palëve të interesit dhe ndërgjegjësimit të komunitetit, e që janë çelësi për çdo ndryshim të qëndrueshëm. Asgjë nga këto nuk do të ishte e mundur pa motivimin e institucioneve tona kryesore partnere, shumica e të cilave janë pjesë e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Rëndësia e Programit është njohur me nënshkrimin zyrtar qeveritar dhe ratifikimin parlamentar të një marrëveshjeje ndërmjet Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve të Kosovës dhe Zyrës Zvicerane për Bashkëpunim. Kjo marrëveshje ofron zotimin e kontributeve të vlefshme dhe të konsiderueshme financiare vendore.

Në këtë drejtim, ne jemi të lumtur t'ju ofrojmë numrin e tretë të Buletinit - Uji i Kosovës. Shpresojmë që të shërbejë si një platformë e dobishme për shkëmbimin e ideve, përvojave dhe sukseseve në lidhje me zbatimin e iniciativave të ndryshme për të mbështetur agjendën e menaxhimit të mjedisit dhe resurseve ujore të Kosovës.

Mezi presim të paraqesim disa rezultate të shkëlqyera në numrat e ardhshëm të këtij buletini.

ROLI I ARPL ËSHTË I PAZËVENDËSUESHËM NË SEKTORIN E UJIT

Intervistë me z. Naser Hafizi

Ushtrues detyre i udhëheqësit të Autoritetit Rajonal Të Pellgjeve Lumore – ARPL
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës – MMPHI



• Rëndësia e themelimit të ARPL dhe roli i këtij Autoriteti në MMPHI dhe Qeveri?

Menaxhimi i resurseve ujore në nivel të pellgut, është domosdoshmëri e kohës.

Deri në vitin 2017, në Kosovë menaxhimi i ujërave në nivelin qendror është administruar nga Departamenti i Ujërave në kuadër të MMPHI. Themelimi i ARPL si autoritet kompetent (Ligji për Ujëra) ka qenë nevojë imediate duke justifikuar rëndësinë e madhe që ky trup ka për sektorin e ujit në Kosovë. Megjithatë, ARPL akoma vepron si vetëm si Departament në kuadër të MMPHI-së me një staf të vogël që ka vetëm 13 nëpunës civil.

Është obligim ligjor që ARPL të ristrukturohet në Agjenci të mirëfilltë me kompetenca ekzekutive që në kuadër të saj të ketë një numër më të madh të personelit të përgatitur profesionalisht, në mënyrë që t'i kryej detyrimet ligjore dhe administrative. Kjo objektivë, nga viti 2021 (përfshirë edhe këtë vit), është futur ndër prioritetet kryesore të Qeverisë të Kosovës.

• Roli i ARPL në gjithë sektorin/industrinë e ujit në Kosovë?

ARPL, në fushën e ujërave, sidomos në zhvillimin e ekonomisë dhe industrisë në Kosovë, ka rol qendror dhe të pazëvendësueshëm.

Sikur në të gjitha vendet e tjera të zhvilluara, por edhe ato në zhvillim si rasti ynë, dhënja e të drejtës ujore për shfrytëzimi/shkarkimi e ujërave, si dhe nxjerrjen e inerteve nga shtretërit e lumenjve është në kompetencën dhe përgjegjësinë e ARPL-së. Mirëpo, nuk duhet harruar faktin që e drejta për ujë të pijshëm është e drejtë elementare dhe e pa cenuar. Fitimi i të drejtës ujore për operatorët ekonomik në Kosovë, realizohet me leje ujore dhe koncesion.

Aktualisht, sipas të dhënave të ARPL-së, të drejtën e shfrytëzimit dhe shkarkimit të ujërave e gëzojnë qindra kompani publike dhe private, duke filluar nga KRU-të (kompanitë e ujësellsve dhe kanlizimeve) të të gjitha regjioneve, kompanitë e prodhimit të hidro energjisë/hidrocentralet, kompanitë e ambalazhimit të ujit, pishinat, qumshtoret, kompanitë e prodhimit të betonit etj.

• Sfidat me të cilat ballafaqoheni ju, si Ushtrues detyre i udhëheqësit por edhe ARPL në tërësi?

Në ARPL, në cilësinë e Ushtruesit të detyrës të udhëheqësit, jam emëruar në fundin e shtatorit të vitit 2021. Fillimisht jam ballafaquar me shumë sfida: si mungesë të një sistemi të pagesave ujore dhe projekteve kapitale si dhe probleme të mos arkëtimit të detyrimeve financiare. Pas një angazhimi disamujor me nëpunësit brenda ARPL, është arritur të krijohet një sistem solid i pagesave ujore dhe ligjshmëri në realizimin e projekteve kapitale në fushën e ujërave.

Pengesat tjera të cilat s'janë aspak për t'u neglizhuar, janë: deficitin e zyrtarëve për kryerjen e detyrave ligjore, mungesa e planeve për menaxhimin e pellgjeve lumore, grumbullimi i qindra (rreth 300 sosh) i kërkesave/aplikimeve për akte ujore, realizimi i projekteve kapitale në kundërshtim me procedurat ligjore, mungesa e databazave valide dhe të besueshme për aplikim, probleme të shumta me prona ujore dhe shumë e shumë çështje të tjera.

• Bashkëpunimi me Programin IWRM-K dhe donator tjerë në fushën e ujit

Aktualisht, përkundër stafit deficitar që ka ARPL, kemi një bashkëpunim shumë të mirë dhe korrekt me Programin e IWRM-K. Për MMPHI, në veçanti ARPL, hartimi dhe finalizimi i Planeve Menaxhuese të Pellgjeve Lumore (PMPL), mbetet objektivi kryesor në këtë bashkëpunim. Hartimi i PMPL, për 3 pellgjet (Ibër, Lepenc dhe Moravë e Binçës) ka filluar vitin e kaluar, janë krijuar grupet punuese tematike, tempoja e të cilave për shkak të kufizimeve nga COVID19, pak sa është ngadalsuar, por pas pandemisë, besoj që do të kemi një intensitet të shtuar të aktiviteteve në realizimin e objektivave të projektit.

Në sektorin e ujërave, donacionet nuk kanë munguar asnjëherë dhe ekziston një numër i konsiderueshëm i tyre, që nga paslufta e tutje.

• Synimet dhe planet në të ardhmen

Ristrukturimi i ARPL-së në Agjenci, që shpresoj se do të ndodhë shumë shpejtë, është synim për fillimin e punëve të mëdha që e presin sektorin e ujërave. Sipas prioriteteve të Qeverisë dhe të MMPHI-së, është "vit i digave" sepse këtë vit, po startohet me projektin e fazës së dytë të IBER-LEP-ENCIT, që parashihet ndërtimi i digës së Firajës, i cili do të përfundon në 2025 dhe pastaj diga e Shtimës që përfundon në vitin 2031. Gjithashtu këtë vit është ratifikuar marrëveshja e huasë me Bankën Botësore e projektit FLOWS për Digën Kikë – Kremenatë. Gjithashtu, në buxhetin e Kosovës, për këtë vit figuronë mbi 2 milion euro, prej të cilave parashihet të hartohen studime të fizibiliteteve për disa diga si psh. Pollata, Dragaçina, Drelaj etj.

Synime të tjera që janë në funksion të menaxhimit sa më të qëndrueshëm të resurseve ujore, janë: trajnimi sistematik i zyrtarëve publik të ARPL-së, përmirësimi i kualitetit të akteve ujore, krijimi i sistemit softwerik të pagesave ujore, ligjshmëria në realizimin e projekteve kapitale në fushën e ujërave, definimi i pronave ujore, bashkëpunimi ndër-institucional dhe me të gjitha palët e interesit.

Uji është trashëgimia jonë, le të lëmë një testament

Dr. Laura Kusari, Profesor i Asociuar
Departamenti Hidroteknik, Fakulteti i Ndërtimtarisë
Universiteti i Prishtinës



Do të filloj me një citim nga National Geography: "I gjithë uji që do të jetë ndonjëherë, është pikërisht tani". Fatkeqësisht, jo vetëm që po përjetojmë mungesë uji tani si pasojë e realiteteve të njohura, por edhe resurset tona ujore janë të degraduara. Menaxhimi i resurseve ujore është një sfidë globale, e cila kërkon edukimin dhe punësimin e specialistëve me njohuri të gjera dhe të larmishme.

E themeluar në vitin 1979, Katedra Hidroteknike në Universitetin e Prishtinës ndihmon Kosovën të zgjidhë problemet aktuale të menaxhimit të burimeve ujore.

Që nga viti 2002, programi i studimit i Departamentit Hidroteknik është organizuar në përputhje me Deklaratën e Bolonjës me një sistem të arsimit të lartë me dy cikle. Departamenti Hidroteknik ofron diploma bachelor dhe master, duke lejuar njohjen e kualifikimeve dhe të mësuarit në të gjithë Evropën.

Diploma Baçellor e Shkencave në Hidroteknikë synon të përgatisë studentët në inxhinierinë e ujit duke adresuar parimet themelore të inxhinierisë, të tilla si mekanika e fluideve, hidraulika, hidrologjia, hidrogjeologjia, furnizimi me ujë, digat dhe kurse të tjera të ngjashme. Studentët kanë mundësinë të kombinojnë leksionet teorike me një qasje më praktike gjatë këtyre studimeve përmes ushtrimeve në klasë, punës laboratorike dhe ekskursioneve të organizuara gjatë gjithë viteve të studimit. Bashkëpunimi me industrinë është shumë i rëndësishëm dhe promovohet përmes një programi për punë praktike që ndihmon studentët në zhvillimin e rrjetit të tyre dhe mundësive për të punuar në një sërë fushash që lidhen me ujin.

Studentët e nivelit master të Departamentit Hidroteknik marrin njohuri më të thelluara, teorike dhe praktike. Në këtë program, ndër të tjera, studentët mund të përmirësojnë njohuritë e tyre në një sërë fushash përmes një kurrikule moderne, duke përfshirë kërkimin shkencor dhe aftësitë e shkrimit akademik, hidrologjinë e avancuar, modelimin hidraulik, proceset e trajtimit të ujit, inxhinierinë e lumenjve, inxhinierinë e ujitjes dhe kullimit, menaxhimin e resurseve ujore dhe mbrojtjen nga përmbytjet.



Partneriteti ynë Akademik së fundi nënshkroi një marrëveshje me Programin IWRM-K, i cili financohet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe implementohet nga Skat Consulting Ltd (Zvicër), në konsorcium me Agjencinë Austriake të Mjedisit (EAA) për të zbatuar Programin Master për Menaxhimin e Integruar të Resurseve Ujore.

Ne kemi zhvilluar një kurrikulë moderne me ndihmën e partnerëve tanë që përfshin një gamë të gjerë temash të menaxhimit të resurseve ujore dhe janë në proces të akreditimi të programit.

MSc në IWRM pritet të përmirësojë njohuritë tona për sfidat aktuale të resurseve ujore, të thellojë, zhvillojë dhe forcojë aftësitë shkencore dhe teknike të nevojshme për të përballuar këto sfida. Kompletimi dhe modernizimi i Laboratorit të Hidroteknikës kanë qenë nevoja dhe kërkesa që do të realizohen në kuadër të Programit.

Ka kërkesa të konsiderueshme për profesionistët e rinj të ujit në fuqinë e punës. Aftësitë që studentët tanë fitojnë gjatë studimeve i përgatitin ata për karrierë në industritë e lidhura me ujin.

Të diplomuarit tanë janë të punësuar nga një sërë organizatash private dhe publike të përfshira në aktivitete të lidhura me ujin. Dy programet master të Departamentit Hidroteknik do të përgatisin shkencëtarë dhe profesionistë të ardhshëm të ujit për rrjetin botëror të resurseve ujore.

Të diplomuar të shumtë kanë vazhduar karrierën e tyre akademike dhe profesionale në të gjithë Evropën dhe shërbejnë si frymëzim për kolegët e tyre fillestarë.

Të diplomuarit tanë janë simbole krenarie për ne.

DELTARES – PËRVOJË E GJATË NË SHPËRNDARJEN E NJOHURIVE, ZGJIDHJEVE TË ZGJUARA DHE INOVACIONEVE

Deltares është një institut i pavarur jofitimprurës për kërkime të aplikuara në fushën e ujit dhe nëntokësore. Kudo në botë, punon në zgjidhje të zgjuara, inovacione dhe aplikacione për njerëzit, mjedisin dhe shoqërinë. Deltares zbaton njohuritë e saj në Holandë dhe në mbarë botën.

Shkurtimisht, Deltares adreson tre "shumë": shumë ujë, shumë pak ujë, ujë shumë të ndotur. "Shumë ujë" do të thotë që ne ndihmojmë në parandalimin e përmytjeve duke bërë plane dhe duke zhvilluar infrastrukturën. "Shumë pak ujë" do të thotë që ne ndihmojmë për t'u përgatitur për thatësitat, një detyrë e cila do të bëhet gjithnjë e më e rëndësishme tani nën ndryshimet klimatike. "Ujë shumë i ndotur" do të thotë se ne punojmë për cilësinë e ujit, në lidhje me ekologjinë. Ne kombinojmë njohuritë për substancat kimike, efektet mbi organizmat ujorë dhe tek njerëzit, vlerësimin e emetimeve, modelimin se ku përfundojnë substancat, cilat mund të jenë efektet lokale. Në Holandë, ne kemi mbështetur ministrinë dhe autoritetet rajonale të ujërave me zbatimin e Direktivës Kornizë të Ujërave, duke përfshirë Direktivën për Ujërat Nëntokësore. Ne ishim aktivë në grupet e punës së BE-së ku ndamë përvojat me shtetet e tjera anëtare dhe me vendet candidate. Ne duam të shpërndajmë këtë njohuri.

Deltares ka një traditë të gjatë në zhvillimin dhe aplikimin e modeleve. Në parim, të gjitha këto modele janë falas, me burim të hapur dhe të disponueshme për këdo. Modeli ynë i biznesit është të shpërndajmë.


Historia

Deltares (ose organet e tij përbërëse) ka operuar në Holandë dhe jashtë saj për më shumë se nëntëdhjetë vjet. Ajo u formua në vitin 2008 nga bashkimi i organizatave të mëposhtme: Delft Hydraulics (themeluar në 1927), GeoDelft, departamenti i Tokës dhe Ujërave Nëntokësore të TNO (Organizata Holandeze për Kërkime Shkencore të Aplikuara), dhe departamente të specializuara kërkimore të Departamentit Holandez të Punëve Publike, Transportit dhe Menaxhimit të Ujit. Me një qarkullim vjetor prej më shumë se 100 milionë euro, Deltares tani punëson mbi 800 njerëz në Holandë në dy lokacione në Delft dhe Utrecht. Jashtë vendit, Deltares ka zyra dhe filiale në Singapor, Indonezi (Xhakarta), Australi, Abu Dhabi, Amerikën Latine dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës (Deltares USA Inc., Silver Spring).

Angazhimi rajonal

Vitet e fundit, Deltares ka mbështetur gjithnjë e më shumë agjencitë qeveritare në Ballkanin Perëndimor teksa ato përshtaten si me sfidat aktuale ashtu edhe me ato të ardhshme të lidhura me ujin. Kjo ka përfshirë projekte për forcimin e kapaciteteve lokale për zbatimin e Direktivës Kornizë Evropiane për Ujërat, në Maqedoninë e Veriut dhe Serbi; në zhvillimin dhe ofrimin e një sistemi operativ të parashikimit dhe paralajmërimit të përmytjeve për pellgun e lumit Sava; të mbështesë qeveritë vendore në Serbi në planifikimin e menaxhimit të ujit dhe zhvillimin e planeve të ZRRF-së (Zvogëlimi i Rrezikut nga Fatkeqësitë), dhe përmirësimin e qëndrueshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike të aseteve rrugore në Shqipëri.

Deltares është entuziaste për angazhimin e saj aktual në Programin IWRM-K në Kosovë dhe mezi pret të shkëmbejë njohuri mbi menaxhimin e resurseve ujore dhe planifikimin e pellgjeve lumore së bashku me partnerët e saj në Kosovë.




"ÇFARË DO TË THOTË UJI PËR JU?" KONKURSI PËR ESE DHE FOTOGRAFI

Më 4 shkurt 2022, Programi IWRM-K organizoi një ceremoni të vogël për të shpallur fotot dhe esetë më të mira në sfidën me titull "Çfarë do të thotë uji për ju?"

Qëllimi i sfidës ishte ngritja e vetëdijes për rëndësinë e ujit tek të rinjtë dhe studentët në Kosovë.



KONKURSI PËR FOTOGRAFI



LEART BRAHA - BADOVCI



GRESA GRECI - PESTOVA



MOLIKA HAJRIZI - RADAVC

"ÇFARË DO TË THOTË UJI PËR JU?" KONKURSI PËR ESE

Shqipe Krasniqi, Studente

U, J dhe Ë, vetëm tri shkronja, të cilat formojnë fjalën me fuqinë më madhështore "UJË", pa të cilin, bota do ishte një vend i vdekur. Një substancë shumë e thjeshtë, pa shije, pa aromë dhe pa ngjyrë por, që mund të quhet si zgjidhësi i shumë problemeve. Në të njëjtën kohë, mungesa e ujit, shpesh na lë me duar të lidhura. Kur hap rubinetin dhe nuk del asnjë pikë ujë, por ti je tharë nga etja. Apo kur ngjitesh nëpër ndonjë mal dhe gjëja e parë që të shkon në mend sapo të arrish, është të nxjerrësh shishen, e të pishësh aq shumë ujë, por çfarë nëse shishja është e thatë? Tërë kohës do ndjeshë atë mungesë, duke mos mundur as të shijosh ato bukuri për të cilat je ngjitur. Një shishe ujë e bartur dorë më dorë i'u shuan etjen shumë fëmijëve pas atyre lojërave të gjata në lagje, apo kur kthehesh në mbrëmje dhe bënë një tush, me ujë të ngrohtë.

Shumë herë në atë vapë vere, futesh brenda një pishine duke notuar përmes atij uji të freskët. Ose, e keni parasyshë atë ditën më të rëndësishme që të pret të nesërmen, dhe lanë rrobat e përzgjedhura për ti veshur. Ose pas një lajmi të keq, qetëson fytyrën me freskinë e tij. Ndonjëherë edhe rastisja e atij qenit në rrugë, që duket i këputur nga etja dhe i jep ujë të pijë, i cili nuk heziton ta pijë menjëherë, të bënë të posedosh një lumturi magjike. Melodia relaksuese që krijojnë pikat e shiut mbi ombrellën që ti po e mbanë. Apo, përplasja e atyre dallgëve të detit në këmbët e tua, gjersa ti, po vështron atë bukuri të mrekullueshme deti, dhe e tëra "thjeshtë ujë".

Ermira Gashi, Studente

Uji është baza e jetës. Madhështia e ujit tregohet në oaza, ndërsa, indikator për rëndësinë e ujit në progresin e punës së njeriut, janë akuaduktet nga Periudha Romake. Jo më kot, civilizimet historike u krijuan buzë lumenjëve të mëdhenj, Nil, Tiger, Eufrat...

Mbulon 70% të sipërfaqes së tokës, por, prapë nuk është i qasëshëm për një pjesë të madhe të popullatës në botë.

Një ndër elementet më të ndijshëm ndaj ndryshimeve klimatike është uji, në veçanti, pastërtia e tij, duke qenë që reshjet do manifestohen në formë shiu, shpeshësia e tyre sjellë vërshime duke shkaktuar kështu erozion. Një ndër indikatorët e zhvillimit të një shteti, është sasia e shfrytëzueshmërisë së ujit. Abuzimi me ujin lokalisht reflekton në krizën globale ujore. Djegia e lëndëve fosileve për prodhimin e energjisë elektike, ka efekte negative për mjedis dhe shëndet mirëpo, kjo nuk do të thotë se uji mbetet zgjidhja e vetme optimale. Efekti i ujit në morfologjinë e relievit është i madh. Lumenjtë e fuqishëm kanë krijuar kanione, shpella në shkëmbinjët karstik, modifikimi i sipërfaqeve detare, me anë të akullnajave, e kështu me rradhë. Ndotja e lumenjëve, derdhja e kanalizimeve në to, ka penalizuar edhe funksionin rekreativ të shfrytëzimit të tyre.

Sipërfaqet ujore, të këndëshme për sy, qetësim shpirtëror, janë edhe muzë për krijimtari artistike. Uji, vital për zhvillimin e jetës të të gjithë organizmave të gjallë! Shfrytëzimi i duhur, mbrojtja nga ndotja, piskamë nga e ardhmja!

Besijana Kurti, Studente

Të gjithë ne e njohim si "Planet i kaltër", por jo të gjithë jemi të vetëdijshëm që këtij planeti që ka gjithë atë sipërfaqe me ujë po i kanoset kriza. Uji është jetë, e vërtetë, por që ta kemi duhet ta ruajmë. Si komunitet duhet të bëjmë përpjekje që çdo pike të ujit t'ia dimë vlerën. Të shpjegohet se pse njerëzimi do të përballet me krizë të ujit kur sasia e ujit është e njëjtë që nga filltet e jetës në Tokë është pak e vështirë. Uji tashmë si rrjedhojë e ndotjes së drejtpërdrejt, ndotjes së ajrit, të tokës, fenomenit të ngrohjes globale, shirave acidike po kalon në forma të cilat janë të pashfrytëzueshme për qeniet e gjalla apo duhet kosto e lartë financiare për t'i bërë të përdorshme. Jemi dëshmitar të asaj që uji ka qenë dhe është burim i sëmundjeve dhe kjo na e vërteton atë se nuk është gjithçka vetëm sasia, por patjetër duhet të jetë edhe cilësia. As vendi ynë nuk është imun nga mungesa dhe ndotja e ujit. Sektori i burimeve të ripërtitshme të energjisë duhet të drejtohet edhe në fushat tjera sikurse janë energjia e erës, solare, gjeotermale dhe jo të drejtohet vetëm kah hidrocentralet. Kjo po ndikon direkt në biodiversitetin e zonave dhe normalisht në mirëqenien e banorëve pasi e përdorin për ujitje të tokave bujqësore. Ne, si shoqëri, vetëm atëherë kur kemi reduktime të ujit na bie ndër mend që kemi ujitur bimët, pas-truar oborret, rrugët e makinat me ujë të pijshëm, kemi lënë rubinetat hapur gjatë larjes së dhëmbëve, rrobave dhe trupit. E të mos flasim kur na duhet të blejmë ujin në shishe plastike, e që nuk e dimë se sa ka qëndruar në të dhe a është ruajtur si duhet.

Andaj, ta ruajmë ujin sot, që mos ta paguajmë nesër. Dhe kurrë nuk është vonë që t'i ndryshojmë praktikat e këqija që mund të kushtojnë.

#POSTIMETNERRJETETSOCIALE



#PabaraziaGjinore fillon aty ku nuk do të pritej fillimisht: e fshehur në mendjet e njerëzve ku #stereotipet negative mund të gjejnë terren të përshtatshëm.

Megjithatë, #BaraziaGjinore mund të kultivohet me ndihmën e ndërgjegjësimit dhe #edukimit.

Ne mundemi - Ne duhet - Ne do ta bëjmë më mirë!

#IDWGIS

Diarrea është e parandalueshme me ujë të sigurt, por nga diarrea ende vdes nga një fëmijë çdo minutë: <http://wrlid.bg/wee550HRhak>

#IValueWater
#SDG6



Ky **BULETIN**

Mbështetet nga programi IWRM-K i SDC-së i bashkëfinancuar nga Qeveria e Kosovës dhe zbatuar nga Skat Consulting Ltd., St. Gallen, Zvicër dhe Agjencia Austriake e Mjedisit (EAA).

Nëse dëshironi të shihni videon tonë promovuese, klikoni [këtu](#):



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



Integrated Water Resources
Management in Kosovo



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

skat Swiss Resource Centre and
Consultancies for Development

ENVIRONMENT
AGENCY AUSTRIA **umweltbundesamt**^U

Na ndiqni

Facebook: [iwrn_k](#) Instagram: [iwrn_k](#)
linkedin: [iwrn_k](#) twitter: [iwrn_k](#)

www.iwrn-k.com

Na kontaktoni

Skat Consulting Ltd.
Menaxhimi i Integruar i
Burimeve Ujore në Kosovë
Rruga Pashko Vasa 136
Kati I. Nr.5, Pejton
Prishtina, Kosovë
Email: kosovo@skat.ch